



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.183

dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|--|-------|
| Vendim i KM nr.1023, datë 15.12.2010 | Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë, për bashkëpunimin ekonomik.. | 10215 |
| Vendim i KM nr.1025, datë 15.12.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.1642, datë 11.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit”..... | 10217 |
| Vendim i KM nr.1028, datë 15.12.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.500, datë 6.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”..... | 10218 |
| Vendim i KM nr.1029, datë 15.12.2010 | Për disa ndryshime në vendimin nr.759, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2010-2011”..... | 10219 |
| Vendim i KM nr.1031, datë 15.12.2010 | Për shfuqizimin e vendimit nr.297, datë 12.6.1995 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e fondacionit të kulturës “Fan S. Noli”..... | 10220 |
| Vendim i KM nr.1037, datë 15.12.2010 | Për zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II”, sipas nomenklaturës së njësjive territoriale për statistikat (NUTS), të Bashkimit European..... | 10220 |
| Vendim i KM nr.1042, datë 22.12.2010 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i rrethrotullimit në kryqëzimin Bishanakë, në bashkinë e Fierit..... | 10221 |

| | | |
|---|--|-------|
| Vendim i KM nr.1072, datë 31.12.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.333, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve shtetërore” | 10222 |
| Vendim i KM nr.1075, datë 29.12.2010 | Për shtyrjen e afatit të shpalljes e të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e saj të varësisë, si autoritete kontraktore | 10223 |
| Vendim i KM nr.1076, datë 29.12.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010”, të ndryshuar | 10223 |
| Vendim i KM nr.1077, datë 29.12.2010 | Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të pjesshme, dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2010 – 2011..... | 10225 |
| Udhëzim i MPCSSHB nr.2310, datë 16.12.2010 | Për një ndryshim në udhëzimin nr.2365, datë 26.11.2008, mbi zbatimin e vendimit nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar..... | 10228 |
| Udhëzim i MPPT nr.27, datë 20.12.2010 | Për llogaritjen e tarifës së administrimit për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi | 10228 |
| Vendim i ERE nr.111, datë 27.12.2010 | Për fillimin e procedurave mbi rishikimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë | 10234 |
| Vendim i ERE nr.112, datë 28.12.2010 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hec Dragoshtunjë” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike | 10235 |
| Vendim i ERE nr.113, datë 28.12.2010 | Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hec Dunice” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike..... | 10236 |
| Vendim i ERE nr.114, datë 28.12.2010 | Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hec Dunice” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike | 10237 |
| Vendim i ERE nr.115, datë 28.12.2010 | Për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë “Antea Cement” sh.a. dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor po kësaj shoqërie për objektin “Fabrika e çimentos pranë Borizanës, Krujë” | 10238 |
| Vendim i ERE nr.116, datë 28.12.2010 | Për rinovimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. me seri PVO5V, nr.29, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE, nr.85, datë 27.12.2005 | 10238 |

| | | |
|---|---|-------|
| Vendim i ERE nr.117, datë 28.12.2010 | Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike | 10239 |
| Vendim i ERE nr.118, datë 28.12.2010 | Për mospranimin e ankesës së KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.97, datë 7.12.2010 | 10240 |
| Vendim i ERE nr.119, datë 28.12.2010 | Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hec Dragoshtunjë” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike | 10241 |
| | Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Koço Dado .. | 10242 |

VENDIM
Nr.1023, datë 15.12.2010

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË, PËR
BASHKËPUNIMIN EKONOMIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë, për bashkëpunimin ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË, MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Hungarisë (në vijim të quajtura “Palët kontraktuese”),

- *me dëshirën* për të forcuar marrëdhëniet afatgjata ndërmjet vendeve të tyre;
 - *me dëshirën* për të vazhduar dhe forcuar marrëdhëniet e tyre ekzistuese ekonomike tradicionale;
 - *me synim* zhvillimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit të tyre ekonomik, industrial, teknik dhe teknologjik mbi bazën e përfitimit reciprok;
 - *me besimin* që thellimi i kuadrit kontraktual vendos kushte të favorshme dhe një bazë të përshtatshme për bashkëpunim të mëtejshëm;
 - *brenda kuadrit* të legjisllacionit përkatës në fuqi në të dyja vendet dhe në përputhje të plotë me detyrimet e tyre ndërkombëtare;
- kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese, në kuadrin e legjisllacionit të tyre ekzistues, nxitin zgjerimin dhe diversifikimin e bashkëpunimit ekonomik me përfitim të ndërsjellë në të gjitha fushat që i përkasin zhvillimit ekonomik.

Neni 2

Palët kontraktuese, duke pasur parasysh gjendjen e tashme dhe të ardhmen e bashkëpunimit të tyre ekonomik, kanë rënë dakord që ekzistojnë kushtet e favorshme për bashkëpunimin afatgjatë, ndër të tjera, në fushat e mëposhtme:

- prodhimin parësor bujqësor, industrinë përpunuese ushqimore, përpunimin dhe magazinimin e produkteve bujqësore, veçanërisht artikuj ushqimorë;
- ndërtimin e impianteve të reja të energjisë dhe rehabilitimin e centraleve ekzistuese elektrike;
- pajisjet dhe instrumentet elektrike;

- industrinë elektronike dhe elektro-teknike;
 - kërkimin, prodhimin, përgatitjen, trajtimin dhe përpunimin e mëtejshëm, si dhe tregtimin e mineraleve dhe produkteve minerale;
 - industrinë kimike dhe petro-kimike;
 - teknologjinë e paketimit;
 - ambientin;
 - menaxhimin e ujit;
 - pylltarinë dhe industrinë e përpunimit të drurit;
 - kujdesin shëndetësor, teknologjinë mjekësore, industrinë mjekësore dhe farmaceutike;
 - zhvillimin e burimeve njerëzore;
 - politikën e punës dhe punësimin;
 - bashkëpunimin ndërmjet biznesit të vogël dhe të mesëm;
 - teknologjinë e komunikimit të informacionit;
 - transportin, veçanërisht menaxhimin e transportit dhe zhvillimin e infrastrukturës së transportit;
 - infrastrukturën komunale;
 - kërkimin dhe zhvillimin.
- Palët kontraktuese me interes të ndërsjellë mund ta zgjerojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në sfera të reja të bashkëpunimit, p.sh. turizmin, me sugjerimin e institucioneve përkatëse.

Neni 3

Palët kontraktuese do të përpiqen ta zgjerojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin e tyre nëpërmjet mjeteve të përshtatshme, si:

- bashkëpunimi në fushën e integriteteve europiane, me synim përmbushjen e kriterëve ekonomike nga *acquis communautaire*;
- nxitja e lidhjeve dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet politikëbërësve ekonomikë, institucioneve qeveritare, organizatave profesionale, federatave të biznesit, dhomave, subjekteve rajonale dhe lokale, inkurajimi i shkëmbimit të informacionit ekonomik me interes të ndërsjellë, si dhe vizitat e përfaqësuesve të tyre dhe delegacioneve të tjera ekonomike dhe teknike;
- shkëmbimi i informacionit mbi prioritetet e zhvillimit dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së operatorëve të biznesit në projektet e zhvillimit;
- përsheptimi i vendosjes së kontakteve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese ndërmjet komuniteteve të biznesit të të dyja vendeve, duke inkurajuar vizitat, takimet dhe ndërveprime të tjera ndërmjet individëve dhe ndërmarrjeve;
- shkëmbimi i informacionit të biznesit, duke inkurajuar pjesëmarrjen në panaire dhe ekspozita, duke organizuar aktivitete biznesi, seminare, simpoziume dhe konferenca;
- nxitja e pjesëmarrjes më të fuqishme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në marrëdhëniet ekonomike dypalëshe;
- inkurajimi i bashkëpunimit në dhënien e shërbimeve të konsultimit, marketimit, këshillues dhe ekspertizës në fushat e interesit të përbashkët;
- inkurajimi i institucioneve financiare dhe i sektorit bankar për të vendosur kontakte më të ngushta dhe forcuar bashkëpunimin e tyre përkatësisht;
- inkurajimi i aktiviteteve të investimit, themelimi i ndërmarrjeve të përbashkëta, vendosja e përfaqësive të shoqërive dhe zyrave të degëve;
- nxitja e bashkëpunimit ndërrajonal dhe e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar në çështje me interes të përbashkët.

Neni 4

Me lidhjen e kësaj Marrëveshjeje do të krijohet një “Komision i përbashkët”, që do të mbledhet me kërkesë të palëve kontraktuese, rregullisht dhe në mënyrë alternative, në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Hungarisë.

Detyrat e komisionit të përbashkët janë veçanërisht të mëposhtmet:

- Diskutimi i zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike dypalëshe;
- Identifikimi i mundësive të reja për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të ardhshëm ekonomik;
- Përpilimi i sugjerimeve dhe gjetja e zgjidhjeve për përmirësimin e kushteve për bashkëpunim ekonomik;
- Bërja e propozimeve për zbatimin e Marrëveshjes;
- Rishikimi i zbatimit të Marrëveshjes.

Diferencat e mendimeve ndërmjet Palëve kontraktuese mbi zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen në kuadrin e komisionit të përbashkët.

Neni 5

Kjo Marrëveshje, në asnjë mënyrë, nuk cenon detyrimet e Republikës së Hungarisë si shtet anëtar i Bashkimit Europian dhe u nënshtrohet këtyre detyrimeve. Për pasojë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk referohen ose interpretohen, plotësisht apo pjesërisht, në mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë, ndryshojnë ose ndikojnë ndryshe mbi detyrimet e Republikës së Hungarisë që rrjedhin nga traktati i aderimit, traktatet mbi të cilat mbështetet Bashkimi Europian, si dhe nga legjislacioni parësor dhe dytësor i Bashkimit Europian.

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk referohen apo interpretohen, plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të tillë sikur zhvlerësojnë, ndryshojnë apo ndikojnë ndryshe mbi detyrimet e vendosura nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian.

Neni 6

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas marrjes së njoftimit të fundit, që tregon përfundimin e procedurave të duhura ligjore të të dyja vendeve dhe mbetet në fuqi për një periudhë prej tre vjetësh. Pas kësaj, rinovohet automatikisht për periudha pasuese njëvjetore, përveç kur një palë kontraktuese njofton tjetrën me shkrim në lidhje me synimin për ta prishur Marrëveshjen tre muaj para skadimit të saj.

Kjo Marrëveshje mund të modifikohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të palëve Kontraktuese; ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Bërë në Tiranë, më 26 mars 2010, në dy kopje origjinale, në gjuhët: shqipe, hungareze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim dhe zbatim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr.1025, datë 15.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1642, DATË 11.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË PËRRENJAS TË QARKUT TË ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për një ndryshim në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë së Përrenjasit të qarkut të Elbasanit, që

transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Përrenjasit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Përrenjas

Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|--|-------------------------------------|----------------------|
| 212 | Truall | Në pronësi |
| 858, 862 | Infrastrukturë dhe shërbime publike | Në pronësi |

VENDIM
Nr.1028, datë 15.12.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.500, DATË 6.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.500, datë 6.7.2010 të Këshillit të Ministrave, në përbërje të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil, fjalët “Z.Ervin Minarolli, anëtar”, zëvendësohen me “Zj.Lilika Radovicka, anëtare”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1029, datë 15.12.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.759, DATË 15.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE,
BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2010-2011”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 5 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.759, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për vitin e ri shkollor 2010-2011, të japë 1 500 (një mijë e pesëqind) bursa për nxënësit, dhe 1 920 (një mijë e nëntëqind e njëzet) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të vendimit.”.

b) Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para është data 15 janar 2011, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitet e dyta e lart është data 15 nëntor 2010.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1031, datë 15.12.2010

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.297, DATË 12.6.1995 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E FONDACIONIT TË KULTURËS “FAN S. NOLI””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.297, datë 12.6.1995 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e fondacionit të kulturës “Fan S. Noli””.

2. Shuma prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, e dhënë si kapital bazë për veprimtarinë që zhvillon fondacioni “Fan S. Noli”, të kalojë në Buxhetin e Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1037, datë 15.12.2010

**PËR ZBATIMIN E NOMENKLATURËS “SHQIPËRIA NË 3 (TRI) RAJONE NUTS II”,
SIPAS NOMENKLATURËS SË NJËSIVE TERRITORIALE PËR STATISTIKAT (NUTS)¹,
TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të dytë të pikës 7 të nenit 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Integritimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II”, sipas nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat, niveli NUTS II, të Bashkimit European.

2. Tri rajonet janë:

a) Durrësi dhe Veriu;

b) Tirana dhe Elbasani;

c) Jugu.

¹ Rregullore (KE) nr.1059/2003 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 26 maj 2003, për krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS), (Gazeta Zyrtare L 154, 21.6.2003), e ndryshuar me rregulloren (KE) nr.105/2007, datë 1 shkurt 2007, për ndryshimin në shtojcat e rregullores nr.1059/2003 (KE), për krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS), (Gazeta Zyrtare L 39, 10.2.2007).

3. Në zbatim të kësaj nomenklature, organizimi territorial statistikor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë do të jetë sipas nivelit NUTS II.

4. Ngarkohen Instituti i Statistikave, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi, me qëllim përgatitjen e shifrave të produktit të brendshëm bruto për frymë, të harmonizuara me shifrat e nivelit NUTS II, brenda vitit 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1042, datë 22.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRETHRROTULLIMIT NË KRYQËZIMIN BISHANAKË, NË BASHKINË E FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrethrotullimit në kryqëzimin Bishanakë, në bashkinë e Fierit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Fierit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, dhënë në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqet 668.2 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë dy) m² truall dhe 402 (katërqind e dy) m² objekt, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 16 495 374 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Fierit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Fierit.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Fierit, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurive, 668.2 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë dy) m² truall, dhe 402 (katërqind e dy) m² objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Fierit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Fierit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR “NDËRTIMIN E RRETHRROTULLIMIT NË KRYQËZIMIN BISHANAKË” NË BASHKINË E FIERIT

| Nr. | Emër, mbiemër | Sip.truall m ² | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Numri i pasurisë | Zona kadastrale |
|-----|--------------------|---------------------------|------------------------------|---------------|------------------|-----------------|
| 1 | Kastriot Dyrmishaj | 35 | 12 000 | 420 000 | 1/1057 | 8532 |
| 2 | Sefer Ajasllari | 448.7 | 12 000 | 5 384 400 | 1/650 | 8532 |
| 3 | Violeta Kanani | 184.5 | 12 000 | 2 214 000 | 1/565 | 8532 |

| Nr. | Emër, mbiemër | Sip.ndërtese m ² | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Numri i pasurisë | Zona kadastrale |
|-----|-------------------------------------|-----------------------------|------------------------------|-------------------|------------------|-----------------|
| 1 | Sefer Ajasllari | 402 | 2 1087 | 8 476 974 | 1/650 | 8532 |
| | Totali, ndërtesë plus truall | | | 16 495 374 | | |

VENDIM

Nr.1072, datë 31.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.333, DATË 28.4.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE SHETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtutës, të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.333, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave, dispozita e hyrjes në fuqi ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 2011.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.1075, datë 29.12.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES E TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE INSTITUCIONET E SAJ TË VARËSISË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut të parë të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të repartit ushtarak nr.1010, Shkodër, si institucion varësie, si autoritete kontraktore, për të vijuar normalisht dhe për të përfunduar, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit me objekt “Blerje ushqimesh që prishen”.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, institucionet e saj të varësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1076, datë 29.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1282, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË FAKULTETIN E MJEKËSISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.2, 34, 35 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuota e pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të jetë 345, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universitetit i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1

KUOTA E PRANIMIT NË STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

| Nr. | Programi i specializimit | Ministria e Shëndetësisë | Ministria e Mbrojtjes | Ministria e Drejtësisë | Trojet shqiptare | Kuota të pambuluara | Shuma |
|-----|---|--------------------------|-----------------------|------------------------|------------------|---------------------|------------|
| 1. | Alergologji | 3 | - | - | - | 3 | 6 |
| 2 | Anatomi patologjike | 1 | - | - | - | 5 | 6 |
| 3. | Anestezi-reanimacion | 17 | - | - | 1 | - | 18 |
| 4. | Dermatologji | 11 | - | - | - | - | 11 |
| 5. | Endokrinologji | 7 | - | 1 | 1 | 1 | 10 |
| 6. | Gastrohepatologji | 2 | - | - | - | 4 | 6 |
| 7. | Hematologji | 4 | 1 | - | - | 2 | 7 |
| 8. | Diagnozë me imazhe | 6 | 3 | - | - | - | 9 |
| 9. | Kardiokirurgji | 5 | - | - | - | - | 5 |
| 10. | Kardiologji | 5 | - | 2 | 1 | 4 | 12 |
| 11. | Kirurgji e përgjithshme | 10 | 2 | - | 1 (Preshevë) | 2 | 15 |
| 12. | Kirurgji maksilo-faciale | 5 | - | - | - | - | 5 |
| 13. | Laborator klinik-biokimik | 2 | 1 | 1 | 1 (Preshevë) | 3 | 8 |
| 14. | Mikrobiologji | 4 | - | - | 1 | 2 | 7 |
| 15. | Mjek familje | 9 | - | - | 4 | 12 | 25 |
| 16. | Mjekësi interne | 10 | 2 | - | 1 | 6 | 19 |
| 17. | Mjekësi ligjore | - | - | - | - | 5 | 5 |
| 18. | Nefrologji | - | 2 | - | - | 6 | 8 |
| 19. | Neurologji | 1 | 1 | - | - | 4 | 6 |
| 20. | Neurokirurgji | 5 | 2 | - | 1 | 1 | 9 |
| 21. | ORL | 2 | - | 1 | 2 (Preshe.) | - | 5 |
| 22. | Obstetrikë — gjinekologji | 6 | - | - | 1 (Preshe.) | 5 | 12 |
| 23. | Okulistikë | 2 | - | - | - | 3 | 5 |
| 24. | Onkologji | 3 | - | - | 1 | 6 | 10 |
| 25. | Ortopedi-traumatologji | 1 | - | - | 1 | 5 | 7 |
| 26 | Pediatri | 21 | - | - | 1 | 2 | 24 |
| 27. | Pneumologji | - | 1 | - | 1 | 8 | 10 |
| 28. | Psikiatri | 1 | 1 | 2 | - | 2 | 6 |
| 29. | Psikiatri e fëmijëve dhe e adoleshentëve | - | - | - | 1 | 5 | 6 |
| 30 | Reumatologji | 10 | - | - | - | 2 | 12 |
| 31. | Sëmundje infektive | 6 | - | - | 1 | 3 | 10 |
| 32. | Shëndet publik | 10 | 2 | - | - | - | 12 |
| 33. | Terapi stomatologjike | 2 | - | - | - | 4 | 6 |
| 34. | Toksikologji klinike | - | - | - | - | 5 | 5 |
| 35. | Pediatri (e specializuar në okulistikë pediatrike, ORL pediatrike, ortopedi pediatrike) | 6 | - | - | - | - | 6 |
| 36. | Mjek urgjence | 12 | - | - | - | - | 12 |
| | Gjithsej | 189 | 18 | 7 | 21 | 110 | 345 |

VENDIM
Nr.1077, datë 29.12.2010

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE, ME KOHË TË PJESSHME, DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2010 - 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, dhe edukimin në distancë, për vitin akademik 2010-2011, të jetë 1180, e cila ndahet si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të pjesshme | 1040; |
| b) Kuota për transferim studimesh | 40; |
| c) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të huaj | 60; |
| c) Kuota për të përndjekurit politikë | 40. |

2. Kuota e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, dhe edukimin në distancë, e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, të shpërndahet sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur.

3. Kuota për transferim studimesh, e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet aplikantëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

5. Kuota për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahet në bazë të legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Kuota e pranimeve për ish-të përndjekurit politikë ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë. Pranimet do të bëhen vetëm në rast të plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

7. Çdo shtetas shqiptar, që zotëron një diplomë universitare, së paku “Bachelor”, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

9. Tarifat e shkollimit për 90 kredite dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit, për aplikantët që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, dhe edukimin në distancë, në vitin akademik 2010-2011, të jenë për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Përjashtohen nga tarifa e shkollimit aplikantët që fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, dhe edukim në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011, të cilët u përkasin këtyre kategorive sociale: të verbrit, të shurdhrit, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijët e familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, fëmijët e ish-të përndjekurve politikë, fëmijët romë dhe ballkano-egjiptianë.

11. Studentët e paguajnë tarifën e shkollimit, të ndarë në këste, në përputhje me kreditet e lëndëve që do të frekuentojnë në çdo vit akademik. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit për një lëndë sa herë e frekuenton atë.

12. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

13. Shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare, shtetërore, janë përcaktuar mënyra të tjera për tarifat.

14. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1
TABELA E KUOTAVE “MASTER PROFESIONAL”, NË SISTEMIN E STUDIMEVE ME
KOHË TË PJESSHME

| Nr. | Emërtimet e programeve të studimit | UT | UE | Shuma |
|------------|--|------------|------------|--------------|
| 1 | Edukatë qytetare-histori, me profil minor “Gjeografi” | | 50 | 50 |
| 2 | Edukatë qytetare-gjeografi, me profil minor “Histori” | | 50 | 50 |
| 4 | Gjuhë gjermane, me profil minor “Gjuhë shqipe” | | 50 | 50 |
| 5 | Gjuhë frënge, me profil minor “Gjuhë shqipe” | | 50 | 50 |
| 6 | Gjuhë angleze, me profil minor “Gjuhë shqipe” | | 50 | 50 |
| 7 | Gjuhë italiane, me profil minor “Gjuhë shqipe” | | 50 | 50 |
| 8 | Matematikë-fizikë, profil minor “Informatikë” | | 50 | 50 |
| 9 | Matematikë-informatikë, profil minor “Fizikë” | | 50 | 50 |
| 10 | Biologji-kimi, me profil minor “Edukim shëndetësor dhe mjedisor” | | 50 | 50 |
| 11 | Histori-gjeografi, me profil minor “Edukatë qytetare” | | 50 | 50 |
| 12 | Punonjës social me fëmijët dhe familjen | | 80 | 80 |
| 13 | Psikolog në institucione | | 80 | 80 |
| 14 | Kontabilitet | 35 | | 35 |
| 15 | Administrim publik | 70 | | 70 |
| 18 | Administrim biznesi | 100 | | 100 |
| 17 | Marketing | 70 | | 70 |
| 18 | Menaxhim turizmi | 35 | | 35 |
| 19 | Financë | 35 | | 35 |
| 20 | Studime ekonomike europiane | 35 | | 35 |
| | Totali | 380 | 660 | 1040 |

TABELA NR.2
TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR “MASTER PROFESIONAL”, ME KOHË TË PJESSHME
PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011

| Nr. | Universiteti | Tarifë për kredit për program të parë | Tarifë totale për program të parë |
|--------------------------|---|--|--|
| Universiteti i Tiranës | | | |
| Fakulteti i Ekonomisë | | | |
| 1. | Financë | 700 | 6,300 |
| 2. | Administrim-biznes | 700 | 6,300 |
| 3. | Administrim publik | 700 | 6,300 |
| 4. | Menaxhim turizmi | 700 | 6,300 |
| 5. | Marketing | 700 | 6,300 |
| 6. | Kontabilitet | 700 | 6,300 |
| 7. | Studime ekonomike europiane | 700 | 6,300 |
| Universiteti i Elbasanit | | | |
| | Fakulteti i Shkencave Humane | 700 | 63,000 |
| 1. | Edukatë qytetare-histori, me profil minor “Gjeografi” | 700 | 63,000 |
| 2. | Edukatë qytetare-gjeografi, me profil minor “Histori” | 700 | 63,000 |
| 3. | Gjuhë gjermane, me profil minor “Gjuhë shqipe” | 700 | 63,000 |
| 4. | Gjuhë frënge, me profil minor “Gjuhë shqipe” | 700 | 63,000 |
| 5. | Gjuhë angleze, me profil minor “Gjuhë shqipe” | 700 | 63,000 |
| 6. | Gjuhë italiane, me profil minor “Gjuhë shqipe” | 700 | 63,000 |
| 7. | Matematikë-fizikë, profil minor “Informatikë” | 700 | 63,000 |

| | | | |
|-----|--|-----|--------|
| 8. | Matematikë-informatikë, profil minor "Fizikë" | 700 | 63,000 |
| 9. | Biologji-kimi, me profil minor "Edukim shëndetësor dhe mjedisor" | 700 | 63,000 |
| 10. | Histori-gjeografi, me profil minor "Edukatë qytetare" | 700 | 63,000 |
| 11. | Punonjës social me fëmijët dhe familjen | 700 | 63,000 |
| 12. | Psikolog në institucione | 700 | 63,000 |

UDHËZIM
Nr.2310, datë 16.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.2365, DATË 26.11.2008 MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në bazë të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.2365, datë 26.11.2008 "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 "Për përfitimin nga statusi i të verbërve", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 3 të udhëzimit, fjalia e fundit: "Kujdestari duhet të pajiset me raport mjekësor, i cili duhet të përsëritet çdo vit", ndryshohet si më poshtë:

... "Mjeku i familjes do të vërtetojë me raport mjekësor të përvitshëm, kujdestarinë e të verbrit, si person të aftë nga gjendja shëndetësore."

Ky udhëzim hyjn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM
Nr.27, datë 20.12.2010

PËR LLOGARITJEN E TARIFËS SË ADMINISTRIMIT PËR NDËRITESAT E BANIMIT NË BASHKËPRONËSI

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Tarifa e administrimit është detyrimi mujor në para i secilit bashkëpronar, për përballimin e shpenzimeve për administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës së banimit. Asnjë njësi banimi a shërbimi nuk përjashtohet nga pagesa e tarifës mujore edhe kur kjo njësi ka dalje më vete dhe nuk përdor elementet në dukje të bashkëpronësisë, si: hyrja kryesore, ashensori, depo uji, pompë, gjenerator a të tjera të ngjashme.

2. Tarifa e administrimit për secilin bashkëpronar, si rregull, përcaktohet bazuar në shpenzimet e administrimit dhe në kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi të pronarëve të njëjësive dhe mund të korrektohet për njësitë e veçanta sipas pikës 1, për numrin e kateve dhe për masën e përdorimit të objekteve të veçanta, siç përcaktohen në këtë udhëzim.

3. Tarifa mujore e administrimit llogaritet bazuar në buxhetin vjetor që miraton asambleja e bashkëpronësisë për administrimin dhe mirëmbajtjen e bashkëpronësisë, e cila pjesëtohet me 12.

4. Në të gjitha rastet, buxheti vjetor duhet të përfshijë fondin rezervë dhe elementet minimale të paketës së administrimit dhe konkretisht:

- 4.1. pastrimin dhe higjienizimin periodik të bashkëpronësisë;
- 4.2. shërbimin e mirëmbajtjes dhe remontit të ashensorëve;
- 4.3. pagesën për administratorin/shoqërinë e administrimit; dhe
- 4.4. zbatimin e normave detyruese, si p.sh. pajisja e bashkëpronësisë me fikëse zjarri, lyrje shkallësh/hyrjeve etj.

KREU II

SHPENZIMET PËR ADMINISTRATORIN/SHOQËRINË E ADMINISTRIMIT

5. Shpenzimet për administratorin/shoqërinë e administrimit janë në varësi të zërave dhe orëve të punës që do të angazhohet dhe përcaktohet në kontratën që lidhet mes asamblesë dhe administratorit/shoqërisë së administrimit.

Në zërat e punës që mund të mbulohen nga administratori përfshihen, por nuk kufizohen vetëm në to, sa më poshtë:

- 6.1. Veprimtari administrative, si:
 - 6.1.1. informacion të rregullt për bashkëpronarët mbi përdorimin e tarifës së administrimit;
 - 6.1.2. përgatitja dhe paraqitja në mbledhjen e asamblesë e planit financiar për vitin e ardhshëm buxhetor;
 - 6.1.3. nëse autorizohet nga asambleja e bashkëpronarëve, të kërkojë lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit, sipas pikës 2 të nenit 27 të ligjit nr.10 112/2009, si dhe ndjekjen deri në fund të ekzekutimit, për mospagesën e tarifës së administrimit nga ndonjëri prej bashkëpronarëve;
 - 6.1.4. mbledhja, faturimi ose derdhja në llogari bankare të tarifave mujore të administrimit dhe mirëmbajtjes;
 - 6.1.5. përgatitja dhe shpërndarja e njoftimeve;
 - 6.1.6. organizimi i mbledhjeve;
 - 6.1.7. lidhja e kontratave me kompani pastrimi dhe mirëmbajtjeje, kur autorizohet nga asambleja;
- 6.2. Veprimtari mbikëqyrjeje, si:
 - 6.2.1. kontrolli i hyrje-daljeve në objekt;
 - 6.2.2. mbikëqyrja e pastrimit dhe mirëmbajtjes;
 - 6.2.3. kontrolli teknik dhe higjienik i pajisjeve dhe pjesëve të bashkëpronësisë, si sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit, pompë uji, gjenerator, depozitë uji, sistemi i tubacioneve dhe shkarkimit të ujërave të shiut, ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, antena, citofoni, ndriçues, prizave, çelësa, porta, brava, shkallët dhe parrakët e shkallëve, tarraca, pusetat e të tjera si këto;
 - 6.2.4. mirëmbajtja e ashensorit nga personi fizik/juridik i kontraktuar;
 - 6.2.5. zbatimi i normave detyruese sipas nenit 34 të rregullores tip të administrimit të bashkëpronësive në ndërtesat e banimit.
- 6.3. Veprimtari mirëmbajtje/riparimi, si:
 - 6.3.1. zëvendësim i ndriçuesve të djegur, prizave, çelësve;
 - 6.3.2. riparimi i pompës së ujit;
 - 6.3.3. vajosje, grasatim, furnizim me karburant i gjeneratorit;
 - 6.3.4. furnizimi me karburant i kaldajës;
 - 6.3.5. zëvendësim i bravave të prishura;
 - 6.3.6. etj.

KREU III SHPENZIMET PËR MIRËMBAJTJE E PASTRIM

7. Kostot për pastrim janë në varësi të:

7.1. madhësisë dhe formës e sipërfaqeve të mjediseve të përbashkëta, ku ndikon numri i kateve dhe thyerjet e planimetrisë;

7.2. zërave të punëve të pastrimit, si p.sh.: fshirje, larje e dyshemeve dhe shkallëve, pastrim i mureve, pastrimi i pluhurave, larje xhamash etj.;

7.3. frekuencës së pastrimit, p.sh. 1 herë në dy-tri ditë, 1 herë në javë etj.

8. Për të përllogaritur kostot e pastrimit, asambleja u referohet çmimeve që ofron tregu për shërbime të ngjashme, sipas standardeve që kërkohen, referuar 7.2 e 7.3.

9. Për të përzgjedhur ofertën fituese, asambleja mund t'i referohet kostos për njësi (lekë në orë ose lekë për m² sipërfaqe pastrimi), për standardet e kërkuara të pastrimit.

10. Shpenzimet për mirëmbajtje llogariten bazuar në disa parametra, ndër të cilët:

10.1. vjetërsia e objektit dhe e pajisjeve të tij;

10.2. numri dhe lloji i pajisjeve të përbashkëta që kërkojnë mirëmbajtje;

10.3. zbatimi i normave detyruese mbi mbrojtjen kundër zjarrit dhe mirëmbajtjen e ashensorëve;

10.4. zbatimi i standardeve të përcaktuara nga njësia vendore mbi mirëmbajtjen e fasadave;

10.5. cilësia e rifiniturave dhe pajisjeve;

10.6. etj.

11. Në tarifën e administrimit dhe të mirëmbajtjes përfshihen vetëm shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen rutinë, dhe jo ato për mirëmbajtje të jashtëzakonshme ose për punime që synojnë rritjen e cilësisë së objektit dhe të pajisjeve në bashkëpronësi.

12. Me mirëmbajtje rutinë kuptohen punime të parashikuara, si lyerje e brendshme, pastrimi dhe zhbllokimi i tubacioneve, mirëmbajtja dhe furnizimi me karburant i gjeneratorit, e të ngjashme si këto.

13. Me mirëmbajtje të jashtëzakonshme ose punime për përmirësimin e cilësisë kuptohen, p.sh. ndërrimi i derës së jashtme, ndërrimi i pllakave të hyrjes, sivatimi i objektit, lyerja e fasadës, vendosje e ashensorit në objekte që nuk kanë një të tillë ose ndërrimi i atij ekzistues, e të ngjashme me këto.

KREU IV LLOGARITJA E TARIFËS MUJORE PËR ÇDO BASHKËPRONAR

14. Asambleja e bashkëpronarëve për llogaritjen e tarifës së administrimit për çdo bashkëpronar, bazohet në kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi dhe merr në konsideratë masën e përdorimit të elementeve të veçanta të bashkëpronësisë nga pronarët e çdo njësie individuale. Në shtojcën 1 jepet një shembull për llogaritjen e tarifës së administrimit për çdo bashkëpronar dhe sqarime mbi mënyrën e llogaritjes.

15. Me masë përdorimi, sipas pikës 14, kuptohet frekuenca e përdorimit të pajisjeve dhe e objekteve të instaluara në godinë. Kështu, bashkëpronarët e kateve përdhe, që nuk përdorin ashensorin, mund të përjashtohen nga kjo pagesë. Për njësitë që përdoren për shërbime, në varësi të aktivitetit të tyre, asambleja mund të miratojë një tarifë më të lartë. Për familjet që nuk banojnë për një kohë më të gjatë se 6 muaj në banesë, mund të reduktojnë tarifën e administrimit dhe të mirëmbajtjes.

16. Asambletë e bashkëpronarëve për të lehtësuar llogaritjen e tarifës së administrimit, mund të miratojnë një tarifë fikse për çdo bashkëpronar, pavarësisht nga shkalla e përdorimit, ose mund të ngarkojnë administratorin për të përcaktuar shkallën e përdorimit të elementeve të veçanta nga ana e pronarëve të njërive individuale, për elemente të veçanta të bashkëpronësisë, shkallën e amortizimit të tyre, si dhe të sugjerojnë koeficientin ose kontributin e pjesëmarrjes për secilën njësi individuale në tarifën e administrimit.

17. Mbi bazën e pretendimeve të pronarëve të njërive të veçanta, administratori verifikon nëse ata përdorin ose jo pjesë a pajisje të veçanta, si: hyrje/dalje në objekt, aparat për matjen e konsumit të ujit dhe të energjisë elektrike për pjesët e përbashkëta, shkarkime të ujërave të zeza e tubacione të ujit të pijshëm, oxhaqe të dala jashtë ndërtesës, shkallë, ashensor etj.

18. Pas verifikimit, administratori/shoqëria administruese përgatit raportin e verifikimit dhe ia paraqet kryesisë së asamblesë së bashkëpronarëve, e cila duhet që brenda 30 ditëve të përgatitë edhe propozimin për tarifën e administrimit për secilin bashkëpronar dhe ta paraqesë për miratim në mbledhjen e asamblesë së bashkëpronarëve, e cila duhet të mbledhet brenda 10 ditëve.

19. Për efekt të llogaritjes së tarifës së administrimit, asambletë marrin në konsideratë edhe shtesat në lartësi apo ato anësore që mund të jenë bërë më pas.

20. Për depozita individuale të ujit, antena a pajisje të tjera, të vendosura në tarracat e përbashkëta nga bashkëpronarë të veçantë, asambleja e bashkëpronarëve ka të drejtë të vendosë që secili pronar i tyre të paguajë një tarifë mujore fikse në formën e një qiraje për përdorimin e tarracës së përbashkët. Të ardhurat do të përdoren nga ana e administratorit/shoqërisë administruese vetëm për mirëmbajtjen e tarracës.

21. Ngarkohen asambletë e bashkëpronarëve dhe administratorët/shoqëritë e administrimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

SHTOJCA 1:

Tabela 1: Shembull për llogaritjen e tarifës së administrimit për çdo bashkëpronar

| nr. Apart. | Emri/mblenri i pronarit | Përdorimi i Njesise | KPB ¹ | Tarifa e pa korrektuar | Pastrimi/higjienizimi | | Ashensori | | Mirembajtje/riparime/lyerje | | fondi rezerve | Tarifa pas korrektimit | |
|--------------------|-------------------------|---------------------|------------------|------------------------|-----------------------|---------------------|------------------|----------------------|-----------------------------|-----------------------------|---------------|------------------------|----------|
| | | | | | tarifa sipas KPB | Tarifa e korrektuar | Tarifa sipas KPB | korrektuar per katin | sipas KPB | Sipas llojit te aktivitetit | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| Kati Perdhe | | | | | | | | | | | | | |
| 1.00 | | zyre avokatie | 1.72% | 725.99 | 209.27 | 251.12 | 120.40 | - | 313.90 | 17.20 | 17.20 | 65.22 | 647.44 |
| 2.00 | | furre buke | 1.52% | 641.57 | 184.94 | 221.92 | 106.40 | - | 277.40 | 15.20 | 22.80 | 57.64 | 579.76 |
| 3.00 | | floktore | 4.00% | 1,688.35 | 486.68 | 584.00 | 280.00 | - | 730.00 | 40.00 | 60.00 | 151.68 | 1,525.68 |
| 4.00 | | Fotograf | 5.00% | 2,110.44 | 608.35 | 730.00 | 350.00 | - | 912.50 | 50.00 | 75.00 | 189.60 | 1,907.10 |
| 5.00 | | Bar/restorant | 6.00% | 2,532.53 | 730.02 | 876.00 | 420.00 | - | 1,095.00 | 60.00 | 120.00 | 227.52 | 2,318.52 |
| | | Total kati perdhe | 18.24% | 7,698.89 | 2,219.26 | 2,663.04 | 1,276.80 | - | 3,328.80 | 182.40 | 295.00 | 691.66 | 6,978.50 |
| Kati i Pare | | | | | | | | | | | | | |
| 6.00 | | Njesi banimi | 4.00% | 1,688.35 | 486.68 | 464.97 | 280.00 | 85.62 | 730.00 | 40.00 | 34.49 | 151.68 | 1,451.14 |
| 7.00 | | Njesi banimi | 3.50% | 1,477.31 | 425.85 | 406.85 | 245.00 | 74.91 | 638.75 | 35.00 | 30.18 | 132.72 | 1,269.75 |
| 8.00 | | Njesi banimi | 3.50% | 1,477.31 | 425.85 | 406.85 | 245.00 | 74.91 | 638.75 | 35.00 | 30.18 | 132.72 | 1,269.75 |
| 9.00 | | Njesi banimi | 9.44% | 3,984.51 | 1,148.56 | 1,097.33 | 660.80 | 202.05 | 1,722.80 | 94.40 | 81.40 | 357.96 | 3,424.69 |
| | | Total kati i pare | 20.44% | 8,627.49 | 2,486.93 | 2,376.00 | 1,430.80 | 357.70 | 3,730.30 | 437.50 | 176.25 | 775.08 | 7,415.33 |
| Kati i dyte | | | | | | | | | | | | | |
| 10.00 | | Njesi banimi | 4.00% | 1,688.35 | 486.68 | 464.97 | 280.00 | 321.06 | 730.00 | 40.00 | 34.49 | 151.68 | 1,591.14 |
| 11.00 | | Njesi banimi | 4.00% | 1,688.35 | 486.68 | 464.97 | 280.00 | 321.06 | 730.00 | 40.00 | 34.49 | 151.68 | 1,591.14 |
| 12.00 | | Njesi banimi | 6.22% | 2,625.39 | 756.79 | 723.03 | 435.40 | 499.25 | 1,135.15 | 62.20 | 53.63 | 235.86 | 2,474.23 |
| 13.00 | | Njesi banimi | 6.22% | 2,625.39 | 756.79 | 723.03 | 435.40 | 499.25 | 1,135.15 | 62.20 | 53.63 | 235.86 | 2,474.23 |
| | | Total kati i dyte | 20.44% | 8,627.49 | 2,486.93 | 2,376.00 | 1,430.80 | 1,073.10 | 3,730.30 | 1,640.63 | 176.25 | 775.08 | 8,130.73 |

¹ KPB – Kuota e Pjesëmarrjes në Bashkëpronësi

| Kati i trete | | | | | | | | | | | | | |
|---------------------|--|--------------|-------|----------|----------|-----------|-----------|----------|-----------|----------|----------|----------|-----------|
| 14.00 | | Njesi banimi | 4.50% | 1,899.40 | 547.52 | 523.09 | 315.00 | 541.79 | 821.25 | 45.00 | 38.80 | 170.64 | 2,166.81 |
| 15.00 | | Njesi banimi | 4.50% | 1,899.40 | 547.52 | 523.09 | 315.00 | 541.79 | 821.25 | 45.00 | 38.80 | 170.64 | 2,166.81 |
| 16.00 | | Njesi banimi | 5.72% | 2,414.35 | 695.95 | 664.91 | 400.40 | 688.68 | 1,043.90 | 57.20 | 49.32 | 216.90 | 2,754.26 |
| 17.00 | | Njesi banimi | 5.72% | 2,414.35 | 695.95 | 664.91 | 400.40 | 688.68 | 1,043.90 | 57.20 | 49.32 | 216.90 | 2,754.26 |
| Total kati i trete | | | | 20.44% | 8,627.49 | 2,486.93 | 2,376.00 | 2,784.50 | 3,730.30 | 2,460.94 | 176.25 | 775.08 | 9,842.13 |
| Kati i Katert | | | | | | | | | | | | | |
| 18.00 | | Njesi banimi | 4.50% | 1,899.40 | 547.52 | 523.09 | 315.00 | 541.79 | 821.25 | 45.00 | 38.80 | 170.64 | 2,166.81 |
| 19.00 | | Njesi banimi | 4.50% | 1,899.40 | 547.52 | 523.09 | 315.00 | 541.79 | 821.25 | 45.00 | 38.80 | 170.64 | 2,166.81 |
| 20.00 | | Njesi banimi | 5.72% | 2,414.35 | 695.95 | 664.91 | 400.40 | 688.68 | 1,043.90 | 57.20 | 49.32 | 216.90 | 2,754.26 |
| 21.00 | | Njesi banimi | 5.72% | 2,414.35 | 695.95 | 664.91 | 400.40 | 688.68 | 1,043.90 | 57.20 | 49.32 | 216.90 | 2,754.26 |
| Total kati i katert | | | | 20.44% | 8,627.49 | 2,486.93 | 2,376.00 | 2,784.50 | 3,730.30 | 2,460.94 | 176.25 | 775.08 | 9,842.13 |
| Total | | | | 100.00% | | 12,167.00 | 12,167.04 | 6,999.80 | 18,250.00 | 7,000.01 | 1,000.00 | 3,792.00 | 42,208.84 |

Për llogaritjen e tarifave mujore, asambleja e bashkëpronësive bazohet në buxhetin vjetor, të nevojshëm për mirëmbajtje dhe administrim. Në tabelën më poshtë jepet buxheti i një bashkëpronësie, e cila përbëhet nga 21 bashkëpronarë.

Tabela nr. 2: Buxheti i bashkëpronësive

| Nr. | Paketa e administrimit | Njesia matëse | kostoja (lekë/njesi) | Sasia | Total vjetor | Total mujor |
|-----|---|---------------|----------------------|--------|--------------|-------------|
| 1 | pastrimi dhe higjienizimi | orë pune | 200.00 | 730.00 | 146,000.00 | 12,166.67 |
| 2 | Kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes dhe remontit të asensorit | muaj | 7,000.00 | 12.00 | 84,000.00 | 7,000.00 |
| 3 | Pagesa për administratorin/shoqërinë e administrimit | orë pune | 400.00 | 547.50 | 219,000.00 | 18,250.00 |
| 4 | Lyerje/riparime/çelësa/brava/gjenerator/pompe uji | | | | 12,000.00 | 1,000.00 |
| 5 | Nen Total | | | | 461,000.00 | 38,416.67 |
| 6 | Fondi rezerve | | | | 46,100.00 | 3,841.67 |
| 7 | Total | | | | 507,100.00 | 42,258.33 |

**SHPJEGIME MBI MËNYRËN E LLOGARITJES SË TARIFËS MUJORE
PËR ÇDO BASHKËPRONAR**

Në këtë shembull është supozuar një objekt në bashkëpronësi, që përbëhet nga 21 bashkëpronarë, në një godinë me 5 kate, të pajisur me ashensor. Është supozuar që asambleja e bashkëpronarëve ka miratuar buxhetin vjetor, të nevojshëm për mirëmbajtje dhe administrim, sipas tabelës nr.2. Buxheti vjetor, që përfshin zërat nga 1-4 dhe fondin rezervë, rezulton 507,100 dhe i ndarë për 12 muaj-42,258 lekë.

Në kolonën 4 të tabelës nr.1, për çdo bashkëpronar është llogaritur kuota e pjesëmarrjes së tij në bashkëpronësi, si raport i sipërfaqes së njësive të tij individuale me shumën e sipërfaqeve të të gjitha njësive individuale.

Tarifa mujore e pakorrektoar për çdo bashkëpronar (kolona 5) llogaritet duke shumëzuar kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi (KPB) (kolona 4) me buxhetin mujor (tabela nr.2, rreshti 7, kolona 6).

Në kolonat në vijim të tabelës nr.1, për efekt krahasimi dhe me të njëjtën logjikë si më sipër, janë llogaritur pjesët përbërëse të tarifës mujore të çdo bashkëpronari sipas zërave të buxhetit.

Zërat që janë korrektoar në këtë shembull kanë të bëjnë me:

1. masën e përdorimit të ashensorit nga kati përdhe, kati i parë dhe i dytë;
2. ndotjen më të madhe që mund të sjellin katet përdhe, për shkak të aktivitetit të tyre, e cila reflektohet në rritjen e kuotës për pastrim;
3. me nivelin më të lartë të përdorimit të pompës së ujit, gjeneratorit etj., si dhe me nivelin e ndotjes akustike që mund të shkaktojnë aktivitetet e kateve përdhe.

Konkretisht, lidhur me pikën 1, në këtë shembull kati përdhe është përjashtuar nga pagesa për mirëmbajtjen e ashensorit; kati i parë paguan 25 % të tarifës mujore; kati i dytë paguan 75% të tarifës mujore që ngelet pasi zbritet tarifa e katit të parë; kati i tretë dhe i katërt paguajnë të plotë tarifën që ngelet pasi janë zbritur tarifat e katit të parë e të dytë.

E njëjta logjikë është përdorur edhe për 2 e 3.

**VENDIM
Nr.111, datë 27.12.2010**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE MBI RISHIKIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT
ME ENERGJI ELEKTRIKE TË KLIENTËVE TARIFORË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.12.2010, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike të saj dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarja” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Bujar Nepravishta**

VENDIM
Nr.112, datë 28.12. 2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HEC DRAGOSHTUNJË” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, të neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 4 pika 1 germa “g”, të neneve 8 dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe të nenit 18 pika 1 germa “a”, dhe 3 të rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.113, datë 28.12.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC DUNICE”
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, të neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 4 pika 1 germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, të nenit 18 pika 1 germa “a” të rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18. 3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Dunice” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike, dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC DUNICE” sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 të nenit 9, përkatësisht me miratimin nga “CEZ shpërndarja” (OSSH) të pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, është në proces miratimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HEC Dunice” sh.p.k., me aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Trebinje”, “Potgozhan”, “Kalivac”, “Dunice 1”, “Dunice”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.114, datë 28.12.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HEC DUNICE” SHPK
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, të neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, të neneve 8 dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, dhe të nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HEC Dunice” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Dunice” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HEC Dunice” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.115, datë 28.12.2010

PËR HEQJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SHOQËRISË “ANTEA CEMENT” SHA DHE RIKTHIMIN NË STATUSIN E KLIENTIT TARIFOR PO KËSAJ SHOQËRIE PËR OBJEKTIN “FABRIKA E ÇIMENTOS PRANË BORIZANËS, KRUJË”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 germa “a” dhe 8 të rregullores “Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Antea Cement” sh.a., për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor për objektin “Fabrika e çimentos, pranë Burizanës, Krujë”

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe të heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe të vendimit nr.8, datë 29.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010. “CEZ shpërndarja” sh.a., me shkresën nr.8550/1, datë 17.12.2010, konfirmon se është e gatshme të furnizojë me energji elektrike, duke filluar nga data 1.1.2011, shoqërinë “Antea Cement” sh.a. nën skemën e çmimeve të rregulluara të miratuara nga ERE për vitin 2011.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. T’i heqë statusin e klientit të kualifikuar shoqërisë “Antea Cement” sh.a. dhe rikthimin e saj në statusin e klientit tarifor për objektin “Fabrika e çimentos pranë Borizanës, Krujë”, duke filluar nga data 1 janar 2011.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.116, datë 28.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK ME SERI PVO5V, NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 13 dhe 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr.29, seria PVO5P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë 10238

Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit, siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës nr.29, seria PVO5P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.117, datë 28.12.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “RUDNAP ENERGY TIRANA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, dhe të nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 4 pika 1 germa “f”, të nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, të nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.118, datë 28.12.2010

**PËR MOSPRANIMIN E ANKESËS SË KESH SHA PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.97, DATË 7.12.2010**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikave 4.2, 4.7 dhe 5.7 të modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338 datë 23.4.2008, të ndryshuar, nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me vendimin nr.18, datë 21.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi analizoi kërkesën e KESH sh.a. për ankimin e vendimit nr.97, datë 7.12.2010 dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Drejtorisë së Tarifave dhe çmimeve për këtë çështje,

Konstaton se:

- Kërkesa e KESH sh.a. është paraqitur në ERE, në kapërcim të afateve procedurale (neni 16 i Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s).

- KESH sh.a. ka qenë në njohje të plotë të vendimmarrjes së ERE-s, ç’ka e dëshmon edhe prezenca e përfaqësuesve të KESH sh.a. në mbledhjen e Bordit të Komisionerëve të datës 7.12.2010, të cilët nuk paraqitën asnjë kontestim dhe për më tepër vlerësuar bashkëpunimin KESH sh.a. - ERE. Edhe nëse do të pranohej si datë e marrjes në dijeni data 14 dhe jo 13, siç dëshmohet në librin e dorëzimeve të ERE-s e të firmosur nga punonjësi i KESH sh.a., afati maksimal i pranimit të kësaj kërkesë në ERE do të ishte data 19 dhjetor 2010, jo data 20.12.2010, që është dhe data e protokollimit të shkresës nga vetë KESH sh.a.

- Në kërkesën e KESH sh.a., ERE nuk konstaton asnjë argumentim që plotëson kërkesat e nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, për provën apo provat e reja, pasi ato të gjitha janë trajtuar si në trajtë pohimesh gjatë seancave dëgjimore ashtu edhe në formë deklarimesh në aplikimin e KESH sh.a. apo dhe shkresave të tjera sqaruese (plotësuese të aplikimit).

- Pohimet e përfaqësuesve të KESH sh.a. për të rikërkuar shqyrtim të të ardhurave të kërkua sipas aplikimit të datës 30.8.2010, jo në kuadër të provave të reja, por si një kërkesë për rishikim në kuadër të të ardhurave shtesë që vijnë nga përdorimi i të ardhurave nga eksporti i energjisë elektrike, si dhe të ardhurat (rezervë) nga TEC Vlorë sh.a., janë në kundërshtim me pikat 4.2, 4.7 dhe 5.7 të modelit të tregut të energjisë elektrike,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.97, datë 7.12.2010.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.119, datë 28.12.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC DRAGOSHTUNJË” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, të neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 4 pika 1 germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, të nenit 18 pika 1 germa “a” të rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 të nenit 9, përkatësisht me miratimin nga “CEZ shpërndarja” (OSSH) të pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, është në proces miratimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HEC Dragoshtunjë” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Zanore”, “Dragoshtunjë”, “Sheja” dhe “Ura”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

KËRKESË

Kërkuesja Suzana Dado, e bija e Sabriut dhe Xhemiles, e datëlindjes 25.8.1963, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Koço Dado.

KËRKUESE
Suzana Dado

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|----------|
| KODI CIVIL | 360 lekë |
| KODI I FAMILJES | 310 lekë |
| KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE | 90 lekë |
| KODI PENAL USHTARAK | 55 lekë |
| KODI I PUNËS | 140 lekë |
| KANONI I ZHURISË | 40 lekë |
| PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE | 328 lekë |
| PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË | |
| PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE | 140 lekë |
| PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË | 512 lekë |

Hyri në shtyp më 16.1.2011

Doli nga shtypi më 18.1.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë